



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:258061

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766678

**C.nr.2484/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. në çështjen kontestimore të paditëses R.S.D. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës MASHT - A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1000 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 31 maj 2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**për shkak të pa dëgjueshmërisë - mosbindjes**

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses R.S.D. nga Prizreni.
- II. DETYROHET e paditura MASHT - A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 31.12.2020 apo për 44 muaj (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 459 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **2651.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 17 .11.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura e paditura MASHT - A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë Institucionit Arsimor SHMP “ Qendra e Kompetencës” në Prizren , ku vazhdon të punojë në këtë institucion, ku ndër të tjera ka theksuar se i takon kompensimi për avancimin në karrierë dhe zhvillim profesional nga neni 7 par1 pika1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit, në lartësi prej 27% të vlerës së pagës bazë dhe atë për periudhën kohore prej 18.04.2017 deri me 31.12.2020, e që deri më tani i është paguar vetëm vlëra prej 63.68euro, e që në bazë të përgatitjes shkollore është dashur që të paguhet shuma prej 123.93 , pra paditëses vlëra prej 60.25 në muaj nuk i është paguar fare. Ashtu që i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit, të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kualifikimit tja bëjë kompensimin në 27% të një page bazë që nga data 18.04.2017 deri me datë 31.12.2020 me kamat ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka marr aktvendim për përgjigje në padi me datë 08 shkurt 2022, të cilën e paditura e ka pranuar me datë 11.02.2022(e cila është konfirmuar përmes fletëkthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së e cila parasheh: *se të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi, se themelësia e kërkesëpadiisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadija nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.*

Themelësia e kërkesëpadiisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë nga kontrata e punës me numër protokollit 142/3 e datës 02.10.2018, lista e pagave me nr. EM00142066, licencës së mësimdhënësit me nr. 1028018 e datës 13.01.2020, Diplomës me numër 1323 të datës 01 shtator 2015, të lëshuar nga UP “Hasan

Prishtina” në Prishtinë, Fakulteti i Edukimit –Qendra në Prizren, vërtetimin me nr. protokoli 116/2021 të datës 21.06.2021

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 21.00 euro, gjithsej shumë prej 125.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 150 par.1 pika a), b), dhe c) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.2484/21, me datë 31 maj 2024**

**G j y q t a r i**  
**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.